



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2021:084037

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06783880

P.nr. 195/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË LIPJAN, departamenti i përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Selman Salih, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Hanife Ibrahim, në çështjen penale ndaj të pandehurit L. B. të cilin e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4239/2017 të datës 28.04.2021, për shkak të veprës penale Arratisja e personit të privuar nga liria, neni 405, paragrafi 1 të KPRK-së Nr.04/L-82. Me datë 31.01.2025 merr dhe publikisht shpall aktgjykimin, dhe me në të njejtën ditë përpilon dhe merr këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

L. B. nga i ati J. i lindur me ... ne B. komuna e L. me nr. personal ... ka te kryer shkollen e mesme profesioni kamarjer i gjendjes se dobet ekonomike i pa martuar .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me daten 27.08.2016 rreth ores 27.08.2016 rreth ores 10.45 minuta I pandehuri L. B. ka perdore forcen qe te arratiset nga Qendra e paraburgimit ne Lipjan i cili ishte ne masen e paraburgimit nga data 02.10.2015 per vepren penale Grabitje .,

-Me këtë ka kryer veprën penale Arratisja e personit të privuar nga liria, neni 405, paragrafi 1 të KPRK-së Nr.04/L-82.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 3, 4, 6, 17, 21, 38, 40, 43, 69 dhe nenit 365 të KPRK-së

G J Y K O N

Me dënim me burg ne afat prej 3 (tre) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

OBLIGOHET i akuzuari A. P., që kësaj Gjykate, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të i'a paguajë shumën prej 20-€, si dhe shumën prej 30-€ për fondin e Viktimave të Krimit, këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj PP/II.Nr.4239/2017 të datës 28.04.2021, e ka akuzuar të pandehurin L. B. për veprën penale Arratisja e personit të privuar nga liria, neni 405, paragrafi 1, të KPRK-së Nr.04/L-82.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, sipas kohës së caktuar.

I pandehuri deklaron: se e ndjenë veten fajtor dhe e pranon fajësinë me vullnetin e tij, pa presion dhe se është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë dhe se veprën e ka kryer gjatë moshës më të re dhe nuk ka mundur t'i kuptojë veprimet e veta, po, tani është i penduar. I njëjti më tej deklaron se veprën nuk e ka përsëritur dhe i premtos gjykatës se nuk do ta përsëris edhe gjatë vazhdimin të vuajtjes së dënimit.

Mbrojtësi i të pandehurit deklaron: pas kunsulltimit paraprake që kam pasur me të mbrojturin tim i njëjti në mënyrë vullnetare pa presion ka pranuar fajsinë në të gjitha fazat të procedurës penale dhe për veprën penale për të cilën e ka pranuar fajsinë ndjen keqardhje dhe është i penduar, dhe njihet gjykatës i premtos se asnjëherë nuk do të përsëris veprën penale. Andaj në rastin konkret gjykatës i propozoj që me rastin e shqiptimit të dënimit të këtyre parasysh rrethanat lehtësuese dhe të njëjtit të shqipton një dënim me kusht për faktin se në kohën kur e ka kryer veprën penale ka qenë i një moshës së re.

Poqëse gjykata të njëjtit të i shqipton një dënim efektiv i propozon gjykatës që me pelqimin e të mbrojturit tim dënimin me burgim efektiv të zëvendësim dhe të shqiptoi një dënim me gjobe.

Prokurori i shtetit deklaron: pajtohem me pranimin e fajësisë dhe i njëjti është i bazuar në prova dhe fakte sipas ligjit konform nenit 242 të KPRK-së. i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor të dënohet sipas ligjit. i propozoj me rastin e matjes së dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rëndues.

Gjykata përkatësisht gjyqtari i vetëm gjykues, i bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë të vullnetshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e qështjes që i përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, konform nenit 242 të KPRK-së gjykata e pranoi pranimin e fajësisë të pandehurve për veprën penale Kanosja nga neni 185 par. 3 të KPRK-së.

Gjykata mbi bazën e pranimin të fajësisë analizoi provat materiale dhe personale në shkresat e lëndës, mbi faktet siç janë: kallëzimi penal i datës 18.07.2017 deklaratën e të pandehurit të datës 04.03.2021. dhe shkresat tjera të lëndës për të cilat vërtetoi edhe gjendjen faktike. Ashtu që gjykata krijoi bindje të plotë, pa dyshim se i akuzuari e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës, andaj edhe të akuzuarin e shpalli fajtor duke i shqiptuar dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit të llojit të dënimit dhe të lartësisë së tij gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rëndues konform nenit 83 të KPRK-së ndaj të pandehurit, ashtu që si rrethanat lehtësuese gjykata vlerëson: pranimin e fajësisë, i njëjti nuk e ka përsëritur veprën penale, ndjehet i penduar në seancë dhe i premtos gjykatës se nuk do të ndodhë më dhe nuk do ta përsërisë veprën penale. Si rrethanat rëndues gjykata vlerësoi peshën e veprës penale, rrethanat, ambientin dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale. Gjykata ka vlerësuar motivin dhe qëllimin që ka rezultuar në vendoshmërinë për marrjen e veprimeve me qëllim të arratisjes nga Qendra Korrektive. I pandehuri ka deklaruar se ka qenë i dënuar një herë për tjetër veprë penale. Gjykata pati parasysh faktin se i pandehuri po sa kishte mbushur moshën 18 vjeçare, megjithatë qëllimi i kryerjes së kësaj veprë penale nga ana e të pandehurit dhe ekzistimi i elementit esencial të fajësisë “dashja” si dhe tek i pandehuri ekziston përgjegjësia penale nga fakti se i njëjti ka qenë

në gjendje të adoleshencës së tij ka kryer veprën penale në rrethana të rrezikshme. Gjithashtu i pandehuri ka vënë në rrezik jetën e tij dhe të zyrtarëve të Qendrës Korrektuse - gardianëve që kanë vrapuar pas tij deri sa e kanë nxënë.

Dënimi i shqiptuar është në propocion me rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Me rastin e marrjes së këtij aktgjykimi, gjykata konstaton se është arritur qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së, ky qëllim ka të bëjë me faktin e rehabilitimit dhe risocializimin e të akuzuarit në rrethanat e ambientit ku jeton dhe në shoqërinë civile në tërësi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u bazua konform nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, kurse vendimi mbi kompensimin e viktimave të krimit u bazua konform nenit 39 të Ligjit për Kompensimin e viktimave të Krimit.

Nga të gjitha arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA NË LIPJAN.
P.nr 195/2021 te dt.30.01.2025

GJYQTARI
Selman Salihi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.